



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201602146/2

Tiranë ___/___/2016

Lënda: *Rekomandim për ndërhyrje dhe mbrojtjen e fëmijëve të shtetases Zh. P nw interesin më të lartë*

Drejtuar: Znj. Alma Agalliu
Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve

Fier

Për dijeni: Z.Armando SUBASHI
Kryetari i Bashkisë

Fier

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit është dorëzuar ankesa e shtetasit Trifon Peto, banues në Bashkinë Fier i cili ankohet për vajzën e tij shtetasen Zhaneta Peto kryefamiljare me dy fëmijë që jetojnë në kushte shumë të vështira sociale-ekonomike në banesën e babait të saj, i cili është i moshuar dhe nuk ka mundësi financiare për ta ndihmuar. Në ankesën e tij zoti Peto sqaron se shtetësja Zhaneta Peto i ka dërkuar një ankesë edhe Kryetarit të Bashkisë, Zotit Armando Subashi ku i ka sqaruar se si rezultat i mungesës së të ardhurave financiare fëmijët e saj akoma nuk janë pajisur me të gjitha librat dhe ushqimi i tyre i përditshëm është vetëm një bukë thatë.

Në mbështetje të nenit 54 të Kushtetutës ku parashikohet se “Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti” çdo fëmijë, gëzon të drejtën për mbrojtje të veçantë nga shteti pavarësisht problematikave të ndryshme.

Në zbatim të VKM nr. 266 datë 12.04.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” dhe Udhëzimit nr.10, datë

25.2.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës” si dhe në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar “*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”;

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave për vlerësimin e riskut të fëmijëve të shtetases Zh. P., dhe hartimin e planit të mbrojtjes për të siguruar mirëqënien e fëmijëve të saj, në interesin më të lartë të tij.

Në zbatim të nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar detyrimi i organeve të administratës për t’ju përgjigjur institucionit të Avokatit të Popullit është brënda 30 ditësh nga data e dërgimit të shkresës zyrtare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI